

Trusti



FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE I KOSOVËS

BULETINI TREMUJOR
NR 59 -- VITI XV -- TM3 2022

TRUSTORJA

PERFORMANCA

PERIUDHA	1 MUAJ	3 MUAJ	VITI AKTUAL	3 VJET	5 VJET	NGA THEMELIMI
REZULTATI	-3.25%	-0.49%	-7.56%	6.54%	11.02%	59.19%
BENÇMARKU*	-0.24%	0.89%	9.72%	17.61%	22.24%	62.82%

*Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit sikurse i publikuar nga Agjencia e Statistikave e Kosovës.

LËVIZJET MUJORE

MUAJI	NDRYSHIMI I ÇMIMIT TË AKSIONIT		KTHIMI BRUTO STANDARD (MLN)	KTHIMI BRUTO KONSERVATIV (MLN)
	STANDARD	KONSERVATIV		
Korrik	+3.53%	+0.29%	€78.56	€0.26
Gusht	-0.66%	+0.29%	€(14.37)	€0.27
Shtator	-3.25%	+0.28%	€(73.84)	€0.26
Tremujori	-0.49%	+0.86%	€(9.65)	€0.79

KONTRIBUIMI

	KONTRIBUTET E REJA STANDARD (MLN)	KONTRIBUTET E REJA KONSERVATIV (MLN)	LLOGARI TË REJA	LLOGARI AKTIVE
Korrik	€22.94	--	4,000	388,502
Gusht	€17.38	--	4,087	398,192
Shtator	€20.56	--	3,281	405,922
Tremujori	€60.88	--	11,368	397,539*

*Mesatarja tremujore

PENSIONIMET

	TË PENSIONUAR	SHUMA E TËRHEQUR
Korrik	573	€5,201,383
Gusht	508	€4,190,916
Shtator	496	€4,127,772
Tremujori	1,577	€14,429,220

PËRMBLEDHJE SHIFRASH

	FUNDI TM3 2022	FUNDI TM2 2022
ÇMIMI I AKSIONIT STANDARD	€1.5919	€1.5997
ÇMIMI I AKSIONIT KONSERVATIV	€2.0414	€2.0240
MJETET NETO NËN MENAXHIM STANDARD	€2,222,209,985	€2,192,679,649
MJETET NETO NËN MENAXHIM KONSERVATIV	€87,020,748	€80,860,046
NUMRI I LLOGARIVE GJITHSEJ	782,420	771,052
NUMRI I LLOGARIVE AKTIVE	405,922	376,835
TARIFA INVESTUESE PËR TREMUJORIN	€1,831,301	€1,853,948
TARIFA OPERACIONALE PËR TREMUJORIN	€326,200	€330,234
INVESTIMET NË KOSOVË	€646,115,734	€629,517,505
INVESTIMET JASHTË	€1,551,856,026	€1,606,297,246
TË PAINVESTUARA (NË BQK)	€112,999,267	€38,636,029

PLASMANET DHE PERFORMANCA NË FUND TË TM3 2022

MENAXHUESI FONDI	NUMRI ISIN / LLOJI INVESTIMIT	PLASMANET FUNDI I TM3 2022	KTHIMI BRUTO NË INVESTIME
Vanguard GSIF	IE00B03HD316	€54,658,325.86	€(2,937,010.29)
Nordea 1-SRF	LU0539147214	€215,960,746.56	€(6,925,233.61)
Nordea 1-GSEF	LU0257969260	€111,293,890.22	€(1,317,631.41)
BNY Mellon RRF	IE00B504KX99	€195,947,375.15	€(10,667,395.17)
Amundi Euro Liquidity-Rated SRI	FR0007038138	€326,525,630.74	€25,025.15
Schroder ISF Global Sustainable Growth	LU2305367323	€1,494,345.00	€17,559.06
BNP Climate Impact	LU0406802768	€2,223,800.55	€(14,161.33)
AXA WF - Framlington Digital Economy	LU1694772994	€1,902,115.60	€(40,657.35)
T. Rowe - Global Technology Equity	LU1244139827	€1,413,185.60	€76,169.13
Amundi Global Disruptive	LU1530899811	€1,889,534.41	€(104,482.19)
Goldman Sachs Global Millennials	LU1820776075	€1,086,717.91	€(20,212.96)
Invesco QQQ UCITS	US46090E1038	€44,147,816.90	€778,982.31
Amundi MSCI Eu Qual Fact	LU1681041890	€20,123,292.00	€(416,313.32)
SP OilGas Expl ETF	US91232N2071	€13,233,491.24	€(1,812,438.25)
US Infrastructure Dev ETF	US37954Y6730	€42,626,355.87	€3,230,699.56
US Infrastructure ETF	US46435U7138	€43,448,483.77	€500,566.05
Invesco DB Base Metals ETF	US46140H7008	€42,803,799.76	€(636,898.17)
iShares Global Clean Energy ETF	US4642882249	€23,248,981.93	€1,531,266.06
Lyxor EUR 2-10Y Inflation Expectations ETF	LU1390062245	€44,510,862.72	€94,099.70
Vanguard Value ETF	US9229087443	€81,284,194.61	€(73,151.55)
Invesco KBW Bank ETF	US46138E6288	€69,736,312.72	€929,662.31
iShares Edge MSCI Europe Val. Factor ETF	IE00BQN1K901	€71,170,522.95	€(3,858,434.56)
Lyxor EURO STOXX Banks ETF	LU1829219390	€43,488,793.47	€1,057,904.70
SPDR S&P Oil & Gas Explor. & Prod. ETF	US78468R5569	€57,017,330.23	€5,874,876.30
iShares Core Dividend Growth ETF	US46434V6213	€21,247,972.97	€(81,647.78)
Global X Cybersecurity ETF	US37954Y3844	€19,372,147.46	€516,610.94
Thesari i Republikës së Kosovës ¹⁾	Letra me vlerë të Qeverisë	€561,993,251.28	€3,449,403.84
Banka në Kosovë ¹⁾	Depozita bankare	€84,122,482.82	€393,800.77
BQK - të gatshme	Të painvestuara	€70,806,349.95	€(22,793.46)
Erste Bank (Broker) - dividenta	Të painvestuara	€42,179,431.07	€1,637,519.01
Të hyra të tjera	--	--	€(49,657.75)
Paraja në dorë dhe në tranzit	Të painvestuara	€13,486.36	--
GJITHSEJ		€2,310,971,027.68	€(8,863,974.26)

¹⁾ Këto janë investime me afat të caktuar maturimi.

LAJME

<p>SQARIM PËR GJENDJEN E INVESTIMEVE</p>	<p>Në fillim të muajit shtator, pas një numri raportimesh mediale për kthimin nga investimet, Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës ka dalë me deklaratë sqaruese për kontribuuesit. FKPK-ja, bazuar në përvojën tashmë 20-vjeçare të operimit, deklaroi se lëvizjet e vlerës së investimeve ndryshojnë përditshëm dhe si të tilla nuk mund të cilësohen si humbje por rënie të vlerës së investimeve. Njëherësh rëniet dhe ngritjet janë pjesë e natyrshme e tregjeve financiare sipas zhvillimeve aktuale në botën makrofinanciare dhe gjeopolitike. Këto rënie do të shndërrohen në humbje të realizuara vetëm nëse FKPK-ja i shet investimet dhe i tërheq mjetet, që do të rezultonte në pamundësi rikuperimi e ngritjeje në të ardhmen.</p> <p>Për t'i ilustruar më mirë lëvizjet periodike, duhet kujtuar se në vitin 2021 FKPK-ja kishte kthim bruto prej +227 milionë euro nga investimet. Gjithashtu aktualisht FKPK-ja ka një ngritje të çmimit të aksionit prej rreth 65% nga themelimi i institucionit, që dëshmon funksionin afatgjatë që e ka strategjia e investimeve.</p> <p>Sa i përket këtij viti (2022) performanca e periudhës janar-qershor është e pritshme, me ambientin aktual të luftës në Ukrainë, krizës energjetike dhe inflacionit dyshifror. Përveç kësaj, pas 30 qershorit kemi pasur ngritje të vlerës së investimeve të FKPK-së, dhe deri në datën e fundit në dispozicion (31 gusht 2022), portofoli "Standard" ka pasur rikuperim prej +3%.</p> <p>Përkundër se kemi rënie të vlerës sivjet, investimet e FKPK-së ranë dukshëm më pak sesa vlera e indekseve kryesore botërore. Për krahasim, deri më 31 gusht 2022, çmimi i aksionit të FKPK-së u zhvlerësua për -4.5%, kurse indeksi i MSCI World ra me -16%, ai i S&P500 me -18% dhe STOXX 600 me -15%.</p> <p>Këto argumente janë për të qartësuar se për kontribuuesin është e rëndësishme që të analizohet gjendja e llogarisë së kursimeve pensionale nga fillimi e deri në datën aktuale, e jo vetëm për një vit kalendarik – pasi edhe institucioni investon me synime afatgjata. Efektin e plotë të investimeve një kontribuues në FKPK e realizon drejtpërdrejt vetëm kur pensionohet. Pikërisht që mos të ketë dëmtrim të interesit të kontribuuesve afër pensionimit, Bordi Drejtues i FKPK-së e ka plasuar portofolin investues Konservativ, që mbron në maksimum mjetet e akumuluarat të kontribuuesve të moshës 63.5 vjeçare e lart. Të njëjtëve iu investohen mjetet vetëm në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës, që kanë interes të paracaktuar. Për këtë vit ky portofol (Konservativ) kishte kthim pozitiv nga investimet prej +1.8%.</p> <p>Bordi Drejtues gjatë vitit 2022 ka bërë maksimumin e mundshëm, duke i lëvizur mjetet në pozitën më mbrojtëse dhe plasuar shumicën e mjeteve në instrumente me rrezik shumë të ulët. Aktualisht rreth 46% e të gjitha mjeteve (ose mbi 1 miliard euro) janë të investuara në tregun e parasë së gatshme, depozitat bankare në Kosovë dhe letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës.</p> <p>Me këtë rast, duam t'i sigurojmë kontribuuesit se në afatgjatë investimet e tyre janë duke u bërë në mënyrën më të kujdesshme dhe gjithnjë bazuar në parimet e Ligjit mbi Fondet Pensionale. Kjo vërtetohet me performancën pozitive në afatgjatë, që secili kontribuues mund ta verifikojë përmes llogarisë personale.</p>
<p>VENDIMET E BORDIT DREJTUES</p>	<p>Bordi Drejtues i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, bazuar në rekomandimet e Komisionit të Bordit për Investime, më 29 gusht 2022 e ka marrë këtë vendim për investimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Të tërhiqet gjysma e ekspozimit në fondin ETF të naftës USO, me kusht që çmimi në kohën e shitjes të jetë mbi 100 dollarë për fuçi për llojin Brent dhe 104 dollarë për fuçi për shportën OPEC. <p>Ndërsa në mbledhjen e 19 shtatorit 2022, gjithnjë sipas rekomandimeve të Komisionit të Investimeve, ka vendosur që:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Të reduktohet me 33% ekspozimi në fondin Lyxor Eurostoxx Banks ETF.

PUBLIKON:
Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës
Tetor 2022

AUTOR
Jeton Demi

ADRESA
Rr. "Agim Ramadani" #182-184 10000 Prishtinë, Kosovë

E-MAIL & UEB
info@trusti.org | www.trusti.org

Facebook:
TrustiPensional

Youtube:
Fondi Pensional i Kosovës